



REPUBLIKA E KOSOVES-REPUBLIKA KOSOVA-REPUBLIC OF KOSOVA QEVERIA E KOSOVES-VLADA KOSOVA-GOVERNMENT OF KOSOVA MINISTRIA E ARSIMIT E SHKENCES DHE E TEKNOLOGJISE MINISTARSTVO OBRAZOVANJA NAUKE I TEKNOLOGIJE MINISTRY OF EDUCATION SCIENCE & TECHNOLOGY SEKTORI I ARKIVES-SEKTOR ARHIVE-ARCHIVE SECTOR	
Njësia Org. Org. Jedinica Org. Unit	5
Nr. i faqeve Br. stranica No. pages	2
Nr. Prot. Broj Prot. Prot. No.	1724
Data: Datum: Date	16.03.2023
Prishtinë / e	

Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria -Vlada-Government

Ministria e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit
Ministarstvo Obrazovanja, Nauke, Tehnologije i Inovacije -- Ministry of Education, Science,
Technology and Innovation

Datë: 16-03-2023
Nr. 5/1724

Komisioni për licencimin e BPrAL në Ministrinë e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit, në mbështetje të dispozitave ligjore nga neni 11 paragrafi 3 dhe 4 dhe neni 14 të Ligjit për Arsimin e Lartë në Republikën e Kosovës nr. 04/L-037, në bazë të neneve 5, 6, 7, dhe 10 të Udhëzimit administrativ nr. 25/2012 për Licencimin e Bartësve Privat të Arsimit të Lartë, shqyrtoi kërkesën nr. 356 të datës 08.02.2023 të parashtruar nga BPrAL- Kolegji "HEIMERER" mori këtë :

V E N D I M

1. Licencohet Bartësi Privat i Arsimit të Lartë - Kolegji " HEIMERER ", me seli në Prishtinë.
2. Licenca zgjat për aq kohë sa institucionit në fjalë akreditimi ndërkombëtar në nivel institucional, sipas vendimit të AKA-s, ref. 958/22 datë 18.07.2022.
3. Licencohet programi i studimeve: "Menaxhimi i institucioneve dhe shërbimeve shëndetësore", MSC 120 ECTS, për periudhën 1 tetor 2022-30 shtator 2027.
4. Nuk licencohen programet e studimeve :
 - a). " Psikologji -Vlerësimi dhe Intervenimi" MA 120 ECTS (akreditim) sipas vendimit të akreditimit nr. ref 30/22 datë 10.01.2022;
 - b). " Psikologji " BSC 180 ECTS , sipas vendimit të akreditimit nr. 138/23 datë 09.02.2023.
5. Vendimi hyn në fuqi me nënshkrimin e tij.

Arsyetim

Në mbështetje të dispozitave ligjore të cekura më lartë, Komisioni për licencim dhe rilicencim të BPrAL i Ministrisë së Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit, pas shqyrtimit të kërkesës nr. 356 të datës 08.02.2023 të parashtruar nga Kolegji "HEIMERER" vlerëson se parashtruesi i kërkesës i ka plotësuar kushtet dhe kriteret ligjore për licencim.

Licenca e këtij Bartësi Privat të Arsimit të Lartë në nivel institucional zgjat pesë vite akademike (1 tetor 2022 – 30 shtator 2027) duke përfshirë edhe programin e studimeve "Menaxhimi i institucioneve dhe shërbimeve shëndetësore", MSC 120 ECTS, sipas vendimit të Agjencionit të Kosovës për Akreditim me ref. 958/22 datë 18.07.2022.

Nuk licencohen programet sipas pikës katër të këtij vendimi, në mungesë të akreditimit nga ana e AKA.

Komisioni për Licencimin e BPrAL në MASHTI, duke marrë parasysh faktet e këtij institucioni të paraqitura në dokumentacionin e kompletuar ligjërisht për aplikim, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë juridike:

Pala e pakënaqur me këtë vendim mund të parashtojë ankesë në afat prej 15 ditësh nga dita e pranimi të këtij vendimi te Sekretari i përgjithshëm i MASHTI.

Vendimi u dërgohet:

1. Parashtruesit të kërkesës;
2. Komisionit për licencim;
3. Sekretarit të përgjithshëm;
4. DALSHT;
5. Inspektoratit të Arsimit;
6. Arkivit.

